



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 123, datë 27.10.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.64, DATË 07.07.2020 “PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË DYTË TË SUBJEKTEVE PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE OSE TË BANESAVE NË NDËRTESA (PALLATE), TË CILAT JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE TË PABANUESHME OSE TË DËMTUARA RËNDË APO TË DËMTUARA LEHTË DHE QË NUK DUHEN RINDËRTUAR NGA E PARA, POR KANË NEVOJË PËR PUNIM RIKONSTRUKSIONI OSE RIPARIME, SI PASOJË E DËMTIMEVE NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM-së nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Urdhërit të zëvendëskryetarit të bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe

Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të VKB-së Nr. 64, datë 07.07.2020 i ndryshuar, përta i përket listës emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar bazuar në ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit.
2. Heqjen nga lista e subjektit përfitues të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur VKB-së Nr. 64, datë 07.07.2020 i ndryshuar, të subjekteve si më poshtë vijon:

NR.	NR. RENDOR NË VKB 64	NR.APLIKIMI	EMËR	MBIEMËR	DS	EKSPERTIZA	VKB FITUES	RAJONI/NJËSIA
1	433	2574	SHPETIM	HOXHA	DS3	RIFORCIM	VKB 64 DT 07.07.2020	RAJONI 4
2	3	26662	AHMET	KONÇI	DS3	PRISHJE	VKB 64 DT.07.07.2020	RAJONI 1

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834/prot.
14

Durrës, më 08.11.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.123 datë 27.10.2022 “Për miratimin e ndryshimit të VKB nr 64 dt 07.07.2020 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare, sipas listës së dytë të subjekteve përfitues të programit të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e shtëpive individuale ose të banesave në ndërtesa(pallate) të cilat janë klasifikuar si objekte të pa banueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punim rikonstruksioni ose riparime, si pasojë e dëmtimeve nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019” i ndryshuar

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

